



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1433/11 Prot.

Tiranë, më 29.05.2023

VENDIM

Nr. 36 datë 29.05 2023

**“PËR
MIRATIMIN E DETAJIMIT TË GRANTIT SHITESË PËR MBULIMIN E
EFEKTEVE FINANCIARE TË RRIJTJES SË PAGAVE NGA BUXHETI, PËR
VITIN 2023 NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS “**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor IAL, në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, të Ligjit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, të Udhëzimit nr.9, datë 20.3.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të Vendimit nr. 243, datë 20.4.2023 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë” të ndryshuar, të Vendimit nr. 242, datë 20.4.2023 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Vendimin nr.234, datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike” i ndryshuar, të Vendimit nr. 77, datë 28.1.2015 të Këshillit të Ministrave “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” të ndryshuar, të shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë n. 8591/1 datë 15.05.2023 “Akordim fondi për rritjen e pagave për vitin 2023”, të shkresës së MAS nr. 2649/60 datë 18.05.2023 “Dërgohet fondi i akorduar për rritjen e pagave për vitin 2023”, të Vendimit të Senatit Akademik nr.54 datë 26.05.2023, “Për miratimin e propozimit të detajimit të grantit shtesë për mbulimin e efekteve financiare të rritjes së pagave , për vitin 2023 në Universitetin e Sporteve të Tiranës” Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 29.05.2023

V E N D O S I :

1. Të miratojë detajimin e grantit shtesë për mbulimin e efekteve financiare të rritjes së pagave nga buxheti për vitin 2023, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori i Universitetit të Sporteve të Tiranës.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek transparenca universitare.

KRYETARI I BORDIT TE ADMINISTRIMIT

Artur Cobani



Tabela: Fondet e detajuara për zbatimin e VKM pagat e sistemit universitare dhe punonjësit mbështetës për periudhën 8 mujore Prill - Nëntor 2023.

Shtesa

Kodi Qeverisjes	Ministri a e Linjes	Institucioni	Emri i Institucionit	Kapitulli	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi I Qarkut	Output kod	Emertimi I Produktit	Buxheti i shtesë I detajuar për mbulimin e efekteve financiare të pagave për prill-nëntor vitin 2023,
										ne lekë
1	11	1011048	Universiteti i Sporteve, Tirane	8	9450	6000000	3535	91105A A	Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve	11.924.265
1	11	1011048	Universiteti i Sporteve, Tirane	8	9450	6010000	3535	91105A A	Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve	718.751

Pakësime

Kodi Qeverisjes	Ministria e Linjes	Institucioni	Emri i Institucionit	Kapitulli	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi I Qarkut	Output kod	Emertimi I Produktit	Buxheti i shtesë per mbulimin e efekteve financiare të pagave për prill-nëntor vitin 2023,
										ne lekë
1	11	1011048	Universiteti i Sporteve, Tirane	1	9450	6040000	3535	91105AA	Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve	12.643.016